

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"**  
**REKTORATI**

Nr. 561 Prot.

Gjirokastrë, më 03.04.2025

**Lënda:** Hapet thirrja për pjesëmarrje në Programin Erasmus+ me Universitetin Goluchowski, Poloni.

Në kuadër të Programit Erasmus+, Universiteti Goluchowski hap thirrjen për shkëmbim studentësh me Universitetin "Eqrem Çabej".

Sipas komunikimeve zyrtare, "Eqrem Çabej" do të marrë pjesë me:

- **4 pozicione** për studentë të Njesisë Bazë të Infermierisë, cikli i parë dhe i dytë i studimit, të cilët do të angazhohen në praktikë mësimore në Universitetin e Goluchowskit. Praktika do të zhvillohet në gjuhën angleze, në periudhën 1 maj - 15 korrik 2025.

Të interesuarit duhet të dërgojnë pranë Sektorit të Koordinimit Ndërkombëtar, Projekteve dhe Kërkimit Shkencor, brenda datës **15.04.2025**:

- vërtetim studenti;
- listë notash;
- letër interesi në anglisht;
- CV të detajuar mundësisht në formatin EUROPASS në anglisht;
- provë / certifikatë të njohurive të gjuhës angleze në nivelin B2;
- fotokopje të pasaportës ose kartës së identitetit.

Dokumentacioni juaj do të vlerësohet paraprakisht nga një komision *ad hoc* i ngritur pranë UGJ-së dhe më pas ky vlerësim do t'i përcillet Universitetit Goluchowski, për vlerësimin përfundimtar të aplikantëve të cilët do të përzgjidhen.

**ZV/REKTORE**

**Prof. asoc. Merita Isaraj**

